

REGJISTRIMI I POPULLSISË, EKONOMIVE FAMILJARE DHE BANESAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, 2021

KONKURSI I TRETË SHITESË PËR ANGAZHIMIN E REGJISTRUESVE RAJONAL

I. Në bazë të nenit 7 të Rregullores për përcaktimin e mënyrës dhe kushteve të përafërta për emërimin e anëtarëve të komisioneve për rajonet e regjistrimit dhe selektimin dhe përzgjedhjen e regjistruesve dhe instruktorëve rajonal, Enti shtetëror i statistikës shpall konkurs për angazhimin e personave të cilët do të marrin pjesë në realizimin e Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2021 në periudhën prej 01-21.04.2021 në cilësinë e:

- **Regjistrues rajonal**

II. Numri i kërkuar i regjistruesve rajonalë që do të zgjidhen sipas rajoneve të regjistrimit dhe sipas gjuhës në të cilën do të kryhet regjistrimi me 10% regjistrues rezervë të përfshirë, është si më poshtë në përmbledhjet tabelare

Pasqyra tabelare për regjistrues dhe instruktorë rajonal

Nr. i rajonit të regjistrimit	Selia dhe komunat që hyjnë në rajonin e regjistrimit	Numri i regjistruesve rajonalë sipas gjuhës në të cilën është kryer regjistrimi							
		regjistrues totali	gj.maqedone	gj.shqipe	gj.turke	gj.rome	gj.vllehe	gj.serbe	gj.boshnjake
2	Dellçevë	5	5	0	0	0	0	0	0
4	Vinicë	14	14	0	0	0	0	0	0
7	Probishtip	20	19	0	0	0	0	1	0
8	Sveti Nikollë	4	0	0	2	0	2	0	0
11	Gjevgjeli	29	28	0	0	0	1	0	0
12	Vallandovë	2	0	0	1	0	0	1	0
13	Kočani	10	5	0	0	0	5	0	0
14	Strumicë	80	80	0	0	0	0	0	0
15	Novo Sellë	45	45	0	0	0	0	0	0
18	Veles	51	20	12	9	1	3	2	4
20	Manastir	50	50	0	0	0	0	0	0
22	Ohër	127	108	12	0	7	0	0	0
23	Strugë	60	20	40	0	0	0	0	0
24	Dibër	15	0	15	0	0	0	0	0
26	Krushevë	6	5	0	0	0	1	0	0
28	Kërçovë	70	20	50	0	0	0	0	0
29	Gostivar	30	8	22	0	0	0	0	0
30	Mavrovë Rostushe	17	14	3	0	0	0	0	0
32	Tetovë	101	11	90	0	0	0	0	0
33	Tearcë	10	10	0	0	0	0	0	0
34	Zhelinë	57	12	45	0	0	0	0	0
35	Aerodrom	130	116	2	2	3	0	6	1
36	Butel	47	35	0	0	2	0	10	0
37	Kisella Vodë	130	120	5	2	0	0	3	0
38	Çair	38	37	0	0	1	0	0	0
39	Gjorqe Petrov	65	62	3	0	0	0	0	0
40	Saraj	5	5	0	0	0	0	0	0

Nr. i rajonit të regjistrimit	Selia dhe komunat që hyjnë në rajonin e regjistrimit	Numri i regjistruarve rajonalë sipas gjuhës në të cilën është kryer regjistrimi							
		regjistruar totali	gj. maqedone	gj. shqipe	gj. turke	gj. rome	gj. vllehe	gj. serbe	gj. boshnjake
41	Karposh	109	104	1	0	3	1	0	0
42	Qendër	108	90	5	2	3	1	7	0
43	Studençani	16	2	7	4	0	0	0	3
44	Shuto Orizare	8	7	1	0	0	0	0	0
45	Gazi Babë	100	80	20	0	0	0	0	0
46	Haraçinë	10	0	10	0	0	0	0	0
47	Petrovec	17	11	6	0	0	0	0	0
48	Ilinden	25	25	0	0	0	0	0	0
49	Kumanovë	59	49	0	3	0	0	7	0

III Kandidatët të cilët do të aplikojnë në këtë konkurs duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Kushtet e përgjithshme

- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Të jenë të moshës madhore,
- Të kenë të kryer së paku arsimin e mesëm, dhe
- Të mos jenë në marrëdhënie pune.

b) Kushte shtesë

- Njohja e punës me kompjuter personal dhe
- Njohja e gjuhës përkatëse të bashkësisë sipas pasqyrës tabelare nga pika II e këtij konkursi.

IV. Përzgjedhja e kandidatëve të paraqitur do të kryhet me testim (kontrolli i njohurive të përgjithshme nga fusha e statistikës dhe njohurive të punës me kompjuter).

V. Testimi do të realizohet në selitë e komisioneve të rajoneve të regjistrimit për kandidatët të cilët kanë vendbanim në rajonin përkatës të regjistrimit.

VI. Koha (ora) e fillimit të testimit dhe vendi (hapësirat) ku do të mbahet testimi në mënyrë shtesë do të publikohen në selinë e çdo Komisioni për rajon të regjistrimit dhe në webfaqen e Entit shtetëror të statistikës www.stat.gov.mk dhe popis2021.stat.gov.mk.

VII. Kandidatët, qëllimin e tyre për të marrë pjesë në Regjistrim e shprehin ekskluzivisht nëpërmjet plotësimit dhe dorëzimit të aplikimit elektronik i cili është në dispozicion në webfaqen e Entit shtetëror të statistikës

<https://www.stat.gov.mk/popis/PrijavaPopis2021.aspx> (aplikimi në gjuhën maqedone) dhe https://www.stat.gov.mk/popis/PrijavaPopis2021_al.aspx (aplikimi në gjuhën shqipe), në periudhë prej **18.03.-20.03.2021**.

Vërejtje: Kandidatët, të cilët shprehën qëllimin e tyre për të marrë pjesë në Regjistrimin 2021 në Konkursin Publik i cili u shpall më 23.02.2021 për aplikim në periudhën nga 23.02-28.02.2021 dhe më 03.03.2021 për aplikim në periudhën nga 03.03-07.03 2021, nuk duhet përsëri të aplikojnë.

VIII. Kandidatët e interesuar të cilët do të dorëzojnë aplikimin në formë elektronike, dokumentet e nevojshme i dorëzojnë ekskluzivisht në formë të letrës nëpërmjet postës deri tek Enti shtetëror i statistikës, rr.Dame Gruev nr.4 Shkup, faksi 506, më vonë deri më 22.03.2021 ose në ditën e planifikimit të testimit në hapësirat ku do të realizohet testimi.

IX. . Dokumentet e nevojshme të cilat kandidatët duhet t'i dorëzojnë janë:

a) Dëshmi për shtetësi – kopje nga:

- letërnjoftimi
- shtetësia ose;
- dokument të rregullt udhëtimi

b) Dëshmi që ka të kryer së paku arsimin e mesëm – kopje nga:

- dëftesa
- vërtetimi për arsimin e kryer ose
- diploma për arsim të kryer

c) Deklaratë me shkrim që nuk është në marrëdhënie pune

ç) Deklaratë me shkrim që ka njohuri lidhur me punën në kompjuter personal

X. Angazhimi i kandidatëve të paraqitur do të bëhet në bazë të kontratës në vepër

XI. Kandidatët me dokumente të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim

XII. Përzgjedhjen e kandidatëve të cilët do të angazhohen në Regjistrim do ta kryej drejtori i Entit shtetëror të statistikës, me propozim të grupit punues përgjegjës, të formuar për çdo rajon të regjistrimit.

XIII. Përzgjedhja e kandidatëve të paraqitur do të bëhet në afat prej 3 ditësh pas testimit, ndërsa lista e kandidatëve të përzgjedhur do të publikohet në webfaqen e Entit shtetëror të statistikës. www.stat.gov.mk dhe popis2021.stat.gov.mk.

Скопје,
17.03.2021

Enti shtetëror
i statistikes